



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06/IA019

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 11 prill 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), bazuar në nenet 33(1)(c) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullat 77, 169 dhe 170(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullat 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit në vijim të Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Autorizimin e Masave Mbrojtëse Përkatëse nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“Vendimi për Miratimin e Lejes për Apelim”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 mars 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Autorizimin e Masave Mbrojtëse Përkatëse (“Vendimi i Kundërshtuar”).²
2. Më 15 mars 2022, z. Hashim Thaçi kërkoi leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar.³
3. Më 7 prill 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin për Miratimin e

¹ F00764, Vendim ndaj Kërkesës së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Autorizimin e Masave Mbrojtëse Përkatëse, 7 prill 2022.

² F00727/CONF/RED, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Autorizimin e Masave Mbrojtëse Përkatëse, 8 mars 2022 (konfidenciale).

³ F00733, Vendim ndaj Kërkesës së Thaçit për Autorizim për Apelim të Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Autorizimin e Masave Mbrojtëse Përkatëse, 15 mars 2022.

Lejes për Apelim, ku miratonte pjesërisht kërkesën e z. Thaçi për leje për apelim.⁴

II. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësen Nina Jorgensen

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me apelin në vijim të Vendimit për Miratimin e Lejes për Apelim.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E hënë, 11 prill 2022
Hagë,
Holandë

⁴ Vendim për Miratimin e Lejes për Apelim, para. 40.